**LIGJ**
**Nr.8342, datë 6.5.1998**

# PËR POLICINË KUFITARE

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

## KREU I
## DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

### Neni 1

Policia kufitare është organ i specializuar i armatosur në përbërje të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Ministrisë të Rendit Publik. Ajo ushtron veprimtari në gjithë gjatësinë e kufirit shtetëror, në vendkalimet kufitare, në vijën bregdetare, në ujërat territoriale, si dhe në thellësi të territorit të Republikës së Shqipërisë.

### Neni 2

Policia kufitare ka për detyrë mbajtjen nën kontroll të kufirit, duke garantuar respektimin e normave të gjithëpranuara të së drejtës ndërkombëtare, të konventave, marrëveshjeve e protokolleve dy a shumëpalëshe për kufirin shtetëror, të nënshkruara nga shteti shqiptar, si dhe të ligjeve të migracionit e të policisë që rregullojnë kalimin e personave, mjeteve të transportit tokësor, ujor e ajror nëpërmjet vendkalimeve kufitare.

### Neni 3

Policia kufitare bashkëvepron me organet e tjera shtetërore për zbulimin dhe zbatimin e masave ndaj veprimeve të kundërligjshme nëpërmjet kufirit shtetëror të Republikës së Shqipërisë.

### Neni 4

Gjatë ushtrimit të detyrës policia kufitare zbaton me përpikmëri dispozitat kushtetuese, kërkesat e ligjit që respektojnë e mbrojnë të drejtat dhe liritë e shtetasve, si dhe aktet e tjera të shtetit shqiptar.

## KREU II
## ORGANIZIMI I POLICISË KUFITARE

### Neni 5

Forcat e policisë kufitare përbëhen nga efektiva oficerë, nënoficerë dhe policë me pagesë. Në përbërje të strukturave të policisë kufitare veprojnë shërbime të speciallzuara të kufirit. Mund të përdoren edhe ushtarë të shërbimit të detyrueshëm ushtarak për shërbime të tjera ndihmëse.

Organika e tyre përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Detyrat funksionale, kompetencat dhe aktet normative që rregullojnë veprimtarinë e policisë kufitare, miratohen nga Ministri i Rendit Publik në mbështetje të këtij ligji.

Neni 6

Uniforma e policisë kufitare është e njëjtë me atë të policisë së rendit publik dhe ka shenjën e vecantë të saj.

Neni 7

Policia kufitare bashkëvepron me organet e tjera të policisë për përmbushjen e detyrave të saj dhe pajiset me mjete speciale e teknike.

## KREU III
## DETYRAT E POLICISË KUFITARE

Neni 8

Policia kufitare kryen këto detyra:

- Siguron kontrollin e kufirit shtetëror të Republikës së Shqipërisë;
- Zbaton masa për parandalimin e kalimeve të paligjshme të kufirit, të trafikut klandestin, të trafikut të armëve, të drogës, të substancave psikotrope e radioaktive, të veprave të artit e muzeore dhe të vlerave valutore.
- Kryen të gjitha veprimet e nevojshme për zbulimin, kapjen, arrestimin në flagrancë dhe bllokimin e mjeteve të transportit e të personave fizikë që hyjnë dhe dalin nga kufiri në mënyrë të paligjshme, me qëllim që të zbatohen ligjet për rendin publik në Republikën e Shqipërisë.
- Kontrollon dokumentacionin identifikues të shtetasve dhe automjeteve e të tyre, të cilët kalojnë nëpërmjet vendkalimeve kufitare.
- Merr masa për ndalimin e personave që kryejnë veprimtari të paligjshme nëpërmjet kufirit,në përputhje me dispozitat e Kodit të Procedurës Penale.

Në rastet kur policia kufitare ka dyshime apo vihet në dijeni për shkelje të normave të Kodit Doganor, njofton menjëherë zyrën doganore kompente. Kjo e fundit merr masa për kryerjen e të gjitha verifikimeve ose formaliteteve të rastit, duke përfshirë edhe njoftimin e organeve të policisë gjyqësore, sipas ligjeve në fuqi.

- zbaton detyrimet të rrjedhin nga konventat ndërkombëtare, marrëveshjet dy a shumëpalëshe për problemet kufitare dhe migracionin, të nënshkruara nga shteti shqiptar.
- Në venddislokimet e saj kryen edhe detyra të ruajtjes së rendit e të qetësisë publike.

## KREU IV
## TË DREJTAT E POLICISË KUFITARE

Neni 9

Në sektorin e dislokimit e të shërbimit policia kufitare ka këto të drejta:

- Të gjitha të drejtat e policisë së rendit dhe të policisë së objekteve.
- Konstaton vlefshmërinë e dokumenteve për kalimin e kufirit të Republikës së Shqipërisë nga shtetas të huaj dhe shqiptarë; jep viza në kufi, konfirmime për viza në kufi miraton leje qëndrimi për të huajt në Republikën e Shqipërisë, brenda kompetencave të njohura në aktet ligjore e nënligjore.
- Kontrollon personat dhe dokumentacionin identifikues të mjeteve të transportit tokësor, ujor e ajror në vendkalimet kufitare dhe, kur është rasti, bën arrestimin në flagrancë dhe ndalimin e personave të kërkuar.
- Organizon takime me organet homologe të shteteve fqinje dhe të vendeve të tjera për zbatimin e marrëveshjeve të përbashkëta dhe shkëmbimin e informacionit në interes të zbatimit të tyre.

Neni 10

Oficerët e policisë kufitare gëzojnë atributet e policisë gjyqësore.

## KREU V
## DISPOZITA TË FUNDIT

### Neni 11

Oficerët, nënoficerët dhe policët pranohen në policinë kufitare sipas kritereve të ligjit nr.7504, datë 30.7.1991 "Për Policinë e Rendit".

### Neni 12

Policia kufitare gëzon trajtim si policia e rendit dhe trajtim suplementar për vështirësi shërbimi e largësie, si dhe ushqim pa pagesë.

### Neni 13

Ngarkohet Këshilli i Ministrave të nxjerrë aktet nënligjore në bazë e për zbatim të këtij ligji.

### Neni 14

Ministri i Rendit Publik nxjerr akte që rregullojnë veprimtarinë e policisë kufitare, si dhe akte të përbashkëta me titullarët e dikastereve të tjera.

### Neni 15

Çdo akt që bie në kundërshtim me këtë ligj, shfuqizohet.

### Neni 16

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë  pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.2098, datë 18.5.1998 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani**